



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrit

Cabinet of the Minister

Kabinet Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Kohëzgjatja e programeve tjera parashkolllore

NUMËR: 44/2007

DATË : 9.10. 2007

Në bazë të nenit 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, nenit 25 paragrafi 7 i Rregullores së Qeverisë së Kosovës nr.1/2007, nenit 14 .3 të Ligjit mbi Edukimin Parashkollor, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (më poshtë MASHT) nxjerr këtë Udhëzim administrativ:

Neni 1

Qëllimi

Ky Udhëzim administrativ ka për qëllim përcaktimin e kohëzgjatjes së programeve tjera parashkolllore që mund të ofrohen në institucione parashkolllore.

Neni 2

Kohëzgjatja

Për kohëzgjatje të programeve tjera që ofron institucioni parashkollor pos atyre të përcaktuara me Ligjin mbi Edukimin Parashkollor, marrja e lejes së veçantë nga DKA-ja, në bashkëpunim me MASHT-in është e obligueshme.

Neni 3

Kohëzgjatja e programeve

Kohëzgjatja e programeve tjera edukative mund të jetë e ndryshme si:

- a) programe me orar të plotë 24 orësh,
- b) programe javore,
- c) programe mujore,
- d) programe sezonale .

Neni 4

Programet me orar të plotë 24 orësh

1. Për realizimin e programeve me orar të plotë 24 orësh, kërkohet punësimi i mjekut.
2. Aplikimi i programeve me orar të plotë 24 orësh, nga institucioni privat apo publik, mund të realizohet gjatë gjithë javës, por së paku një ditë të plotë, ose dy herë nga gjysmë dite në javë, ata fëmijë këtë kohë duhet ta kalojnë me prindër apo familjarë të tyre.

Neni 5

Programet javore

1. Kohëzgjatja e programeve javore jashtë institucionit parashkollor, duhet të jetë deri në 5 ditë e katër netë.
2. Në programet sezonale javore jashtë institucionit parashkollor marrin pjesë vetëm fëmijët e moshës pesëvjeçare.

Neni 6

Programet sezonale

1. Programet sezonale për nga kohëzgjatja mund të jenë të ndryshme. Ato mund të jenë me orar të plotë, gjysmë orari, mujore, javore, varësisht nga niveli i interesimit të prindërve dhe kushteve që mund të ofrohen nga organizatori.
2. Aplikimi i programeve sezonale mund të realizohet edhe jashtë institucionit parashkollor, por paraprakisht niveli i sigurisë duhet të jetë i lartë. Të gjitha kushtet e nevojshme si psh siguria e fëmijëve, transporti, aspekti higjienik, ushqimi e rekreacioni i fëmijëve, si pjesë e planit dhe programit vjetor të institucionit paraprakisht duhet të jetë mirë i planifikuar.

Neni 7

E drejta për pjesëmarrje në programe

- 1.** Asistentët vullnetarë që kanë dëshirë të kontribuojnë në realizimin sa më cilësor të programeve sezonale, mund të marrin pjesë për të ndihmuar.
- 2.** Asistent vullnetar mund të jenë edukatorët e pensionuara (me gjendje të mirë shëndetësore), dhe student-drejtimi për edukatore.
- 3.** Në realizimet e programeve sezonale jashtë kopshtit mund të marrë pjesë edhe ndonjë artist me lejen e DKA-së.
- 4.** Pjesëmarrja e mjekut dhe një motre medicinale është e domosdoshme.
- 5.** Numri i mjekëve dhe motrave medicinale caktohet në bazë të numrit të fëmijëve, për 30 fëmijë nevojitet një mjek dhe një motër medicinale.

Neni 8

Lëvizja e fëmijëve

Çdo lëvizje e fëmijëve jashtë institucionit duhet të realizohet me lejen e prindërve dhe DKA-së.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Agim Veliu, ministër